



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 526/1 Prot.

Tiranë, më 24.04.2023

V E N D I M

Nr. 62, Datë 24.04.2023

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 157, datë 07.10.2022, e R.O kundër Federatës Shqiptare të Volejbollit (FSHV), në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjinisë”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Referuar pretendimeve të parashtruara në ankesë, rezulton se ankuesja ka filluar aktivitetin si arbitër volejboli në vitin 1997 dhe në vitin 2002 ka fituar titullin arbitër kombëtar. Ajo shprehet se duke parë interesimin e madh të Konfederatës Europiane të Volejbollit për pjesëmarrje sa më të madhe të femrave në arbitrimin e volejbollit, ajo konkuroi për të fituar titullin arbitër ndërkombëtar dhe në vitin 2004 e fitoi këtë titull. Marrja e këtij titulli i dha të drejtën të arbitronte edhe jashtë vendit, duke qenë pjesëmarrëse si arbitër në shumë ndeshje ndërkombëtare si për femra ashtu edhe për meshkuj. R.O shprehet se ka qenë tepër e vlerësuar, pasi ishte e vetmja femër shqiptare, arbitër në arenën ndërkombëtare.

Ankuesja pretendon se në vitin 2015, me ardhjen e drejtuesve të rinj të Federatës Shqiptare të Volejbollit, pjesëmarrja e saj si arbitër në aktivitetet sportive është minimizuar pa asnjë arsye. Një gjë e tillë është reflektuar jo vetëm në numrin e vogël të aktiviteteve sportive kombëtare, ku është caktuar të arbitronte, por edhe për faktin se nuk i dërgohej më emri pranë Konfederatës Europiane të Volejbollit, për t’u caktuar si arbitër ndërkombëtar në ndeshje ndërkombëtare. Në vitin 2018, Komisioni i Disiplinës së Federatës Shqiptare të Volejbollit i ka dhënë paralajmërim për

¹ Në vijim do t’i referohemi me akronimin KMD.

përrjashtim nga aktivitetet kombëtare dhe ndërkombëtare për prishje të imazhit të FSHV-së dhe shpifje kundër personave zyrtarë të FSHV-së.

Ankuesja pretendon se në muajin prill 2019, ajo është caktuar nga Konfederata Europiane e Volejbollit të arbitronte një ndeshje gjysëm finale për meshkuj në Greqi. Në vijim, ndaj saj është marrë Vendimi nr. 5, datë 25.10.2019, i FSHV-së, nëpërmjet së cilit R.O është pezulluar për një periudhë 2 vjeçare nga gjykimi i të gjitha ndeshjeve kombëtare dhe ndërkombëtare, ulje me një kategori në gjykim, si dhe gjobë financiare në vlerën 50.000 lekë.

Pavarësisht, se afati i pezullimit ka përfunduar që në datën 25.10.2021, Federata Shqiptare e Volejbollit nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të aktivizuar ankuesen për të arbitruar ndeshje kombëtare apo ndërkombëtare. Në këto kushte, R.O pretendon se diskriminohet për shkak të gjinisë nga ana e Federatës Shqiptare të Volejbollit.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe kthimin në pozicionin e mëparshëm si arbitre e FSHV-së.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar², parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatëzinë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 3, i ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ndalon çdo dallim, përrjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

² Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën nr. 1350/1, datë 20.10.2022, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga FSHV, për ankesën e bërë nga R.O si dhe ka kërkuar aktet e poshtë cituara:
 - Akti administrativ, nëpërmjet së cilit ankuesja është caktuar arbitër kombëtar;
 - Certifikata nëpërmjet së cilës, ankuesja ka fituar titullin arbitër ndërkombëtar;
 - Numri i arbitrave kombëtarë meshkuj dhe femra në FSHV;
 - Numri i arbitrave ndërkombëtarë meshkuj dhe femra në FSHV;
 - Informacion mbi arsyet e dhënies së Vendimit nr. 5, datë 25.10.2019, të FSHV;
 - Fakte dhe prova lidhur me veprimet dhe mosveprimet e ankueses që kanë sjellë si pasojë marrjen e Vendimit nr. 5, datë 25.10.2019, të FSHV. Të depozitohen në cilësi prove pranë KMD-së të gjitha aktet mbi të cilat është mbështetur vendimmarrja e FSHV;
 - Informacion mbi procedurat paraprake që ka ndjekur FSHV, duke i garantuar ankueses të drejtën për t’u dëgjuar dhe për të paraqitur observacionet e saj, para marrjes së vendimit të sipërcituar;
 - Të dërgohet në cilësi prove e gjithë praktika shkresore e FSHV-së, për dhënien e vendimit nr. 5/2019;
 - Informacion nëse ankuesja e ka kundërshtuar administrativisht Vendimin nr. 5, datë 25.10.2019, pranë FSHV-së ose pranë Konfederatës Ndërkombëtare të Volejbollit;
 - Informacion nëse ankuesja e ka kundërshtuar gjyqësisht Vendimin nr. 5, datë 25.10.2019, e FSHV-së;
 - Informacion mbi veprimet e ndërmarra nga Federata Ndërkombëtare e Volejbollit, për aktivizimin e ankueses në cilësinë e arbitrit kombëtar dhe ndërkombëtar, pas përfundimit të afatit të pezullimit të përcaktuar në Vendimin nr. 5, datë 25.10.2019, të FSHV-së;
 - Informacion mbi faktin nëse masa e gjobës është shlyer nga ankuesja;
 - Informacion nëse ndaj ankueses janë marrë masa disiplinore përgjatë periudhës që ka qenë arbitër kombëtar dhe ndërkombëtar;

- Informacion mbi vlerësimet në punë të R.O, në cilësinë e arbitrit kombëtar/ndërkombëtar;
- Informacion mbi të gjitha masat disiplinore të dhëna ndaj arbitrave meshkuj dhe atyre femra, përgjatë viteve 2015-2022, ku të cilësohen se sa prej tyre janë pezulluar dhe rikthyer në detyrë;

Me shkresën nr. 178, datë 31.10.2022, Federata Shqiptare e Volejbollit, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“.....Informacioni i kërkuar nga ana juaj është shumë voluminoz dhe si i tillë kërkon kohë dhe angazhim të burimeve njerëzore. Nisur nga ky fakt ju sqarojmë se informacioni i kërkuar i korrespondon një periudhe 20 vjeçare dhe si rrjedhojë duhen hapur arkivat e FSHV-së. Në kushtet kur FSHV ka në organikën e saj vetëm dy punonjës është e pamundur respektimi i afatit 10 ditor të kërkuar nga ana juaj. Për sa më sipër, kërkojmë mirëkuptimin tuaj për dërgimin e të gjithë informacionit të kërkuar në një moment të dytë....”*.

- Me shkresën nr. 1350/3, datë 23.11.2022, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka kërkuar nga FSHV dërgimin e informacionit të kërkuar me shkresën paraardhëse. FSHV nuk ktheu përgjigje shkresës së KMD-së.
- Me shkresën nr. 1350/4, datë 16.12.2022, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka kërkuar përsëri nga FSHV dërgimin e informacionit, si dhe e ka bërë me dije se në rast të mos dërgimit të tij, KMD do të shprehej me vendim gjobë ndaj këtij subjekti.
- Me shkresën nr. 197, datë 22.12.2022, FSHV informoi Komisionerin se pretendimi i ankueses për diskriminim gjinor ndaj FSHV-së është i pabazuar në fakte dhe në ligj, për disa arsye të cilat parashtrohen me radhë.

FSHV thekson faktin se nuk është një organizatë diskriminuese për shkak të gjinisë dhe në asnjë sjellje apo vendimmarrje të saj nuk është bazuar ndonjëherë në shkaqe që kanë të bëjnë me gjininë. Në këtë kontekst, FSHV vë në dukje faktin se dy nga anëtarët e Bordit të FSHV-së, i cili përbëhet momentalisht nga 6 anëtarë, 2 prej të cilave janë femra, konkretisht Xh.S. dhe G.N, e cila është edhe në rolin e Zv. Presidentes së FSHV-së.

Ankuesja R.O ka cilësinë e arbitrit/gjyqtarit kombëtar dhe ndërkombëtar. Në këtë cilësi, ajo ka marrë detyra nga FSHV, njësoj siç është bërë me arbitrat e tjerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Si provë për të ilustruar sa më sipër, është kërkesa e FSHV-së drejtuar Konfederatës Europiane të Volejbollit (në vijim CEV) në mars të vitit 2018 (email i datës 20.03.2018) për të ndryshuar vendin e arbitrimin në ndeshjet e volejbollit të ligës europiane Silver dhe jo për ta penalizuar, kërkesë e cila u miratua nga CEV (email 22.03.2018), për të zëvendësuar dy arbitra meshkuj, konkretisht A.Sh dhe I.F, të cilët ishin të angazhuar edhe në detyra të tjera organizative të FSHV-së. Provë tjetër ilustruese që vërteton se FSHV-ja nuk ka asgjë kundër gjinisë femër janë për shembull Vendimet nr. 16 dhe 17, datë 08.09.2016, të Komitetit Ekzekutiv të FSHV-së që i kanë refuzuar arbitrave/gjyqtarëve meshkuj, konkretisht A.T dhe E.M, aderimin si gjyqtarë pranë FSHV-së për sezonin sportiv 2016-2017. Këta gjyqtarë e kanë ankimuar vendimin e FSHV-së në Këshillin e Arbitrazhit Sportiv (KAS), i cili e rrëzoi

këtë kërkesë (Vendimi i KAS nr. 1, datë 28.02.2017), duke vërtetuar që vendimet e marra nga Komiteti Ekzekutiv i FSHV-së janë konform Rregullores së Brendshme dhe Kodit të Etikës, si i vetmi organ përgjegjës për mbarëvajtjen e sportit të volejbollit. FSHV, në kuadrin e detyrave të saj për organizimin e aktiviteteve sportive, sipas rrethanave të rastit mund të vlerësojë numrin e përgjithshëm të arbitrave për një sezon të caktuar sportiv dhe përzgjedhjen e arbitrave konkretë, në përputhje me numrin e përgjithshëm të ndeshjeve dhe nevojave të tjera që mund të paraqesë një sezon sportiv. Kërkesat dhe nevojat e FSHV-së për arbitra nuk motivohen nga gjinia e tyre, por vetëm nga cilësitë e tyre etike dhe tekniko-profesionale.

Me Vendimin nr. 5, datë 25.10.2019, Komiteti Ekzekutiv i FSHV-së ka vendosur pezullimin për një periudhë 2 vjeçare të R.O nga gjykimi i të gjitha ndeshjeve kombëtare dhe ndërkombëtare, ulje me një kategori në gjykim dhe gjobë në masën 50.000 lekë. Për këtë vendim, R.O është njoftuar menjëherë dhe ka pranuar ta marrë fizikisht më datë 10.12.2019, ora 08:55, siç ka shkruar me shkrim dore dhe nënshkruar. Ky vendim është marrë për arsye se R.O në raste të përsëritura ka treguar sjellje të këqija, të pahijshme dhe antisportive në fushën e lojës, duke dëmtuar imazhin e FSHV-së. Duhet kuptuar se imazhi dhe prezenca e FSHV-së në fushë të lojës, janë arbitrat/gjyqtarët dhe sjellja e tyre përgjatë lojës nderon ose dëmton imazhin e FSHV-së, në varësi të etikës dhe teknikës profesionale që ata kanë.

Ankuesja ka demonstruar më shumë se një herë se nuk ka ditur të respektojë rregullat etike dhe profesionale të arbitrit në fushën e lojës. Arsye tjetër që ka ndikuar në pezullimin e ankueses është edhe aderimi i saj në një klub sportiv volejboli, konkretisht Klubi Sportiv Tirana (në vijim KS Tirana), detyrë e cila bie ndesh me ushtrimin e rolit të gjyqtarit/arbitrit të volejbollit, pasi është në konflikt interesi të pastër me arbitrimin e ndeshjeve. Një gjë e tillë është pranuar edhe nga vetë R.O, në sms e datës 29.10.2019, adresuar presidentit të FSHV-së, ku është shprehur se punon për KS Tirana. Për rrjedhojë, nëse ankuesja është ndjerë e trajtuar ndryshe për shkak të Vendimit nr. 5, datë 20.10.2019, të Komitetit Ekzekutiv të FSHV-së, ky trajtim nuk ka ardhur për shkak të gjinisë, por për arsye të përligjura. Afati i pezullimit ka përfunduar në datën 24.10.2021, por nga ana e ankueses nuk është depozituar asnjë kërkesë me shkrim në FSHV për të vazhduar veprimtarinë si gjyqtare/arbitre pranë FSHV-së, si dhe ende nuk është paguar gjoba në shumën 50.000 lekë.

Në këto kushte, FSHV thekson se jo vetëm nuk ka asnjë diskriminim për shkak të gjinisë ndaj R.O, por bazuar në nenin 33, pika 4, gërma “ç”, të LMD-së të ndryshuar, KMD nuk duhet ta pranojë ankesën e saj, pasi është haptazi e pabazuar dhe nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim. Nga ana tjetër, FSHV gjykon se për rastin e ankesës së R.O, ndodhemi në kushtet e parashkrimit, pasi ankesa nuk pranohet nëse paraqitet më vonë se 2 vjet nga marrja dijeni për sjelljen diskriminuese, ndërkohë që vërtetohet se ankuesja ka marrë dijeni mbi Vendimin nr. 5, datë 25.10.2019, të Komitetit Ekzekutiv të FSHV-së, në datën 10.12.2019, siç ka shënuar me shkrim dore dhe ka nënshkruar. Për rrjedhojë afati 2 vjeçar për pranimin e ankesës nga marrja dijeni për sjelljen diskriminuese ka përfunduar në datën 09.12.2021, ndërsa ankesa tek KMD është bërë në datën 07.10.2022.

- Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, Komisioneri me shkresën nr. 48, datë 10.01.2023, njoftoi palët për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 19.01.2023, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e palëve në proces.

Seanca u zhvillua në datë 19.01.2023 dhe mori pjesë vetëm subjekti ankues. Federata Shqiptare e Volejbollit, me e-mail-in datë 17.01.2023 njoftoi se për shkak të angazhimeve në veprimtaritë sportive e kishte të pamundur pjesëmarrjen në seancën dëgjimore.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Gjatë seancës dëgjimore, subjekti ankues i qëndroi të njëjtave parashtrime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit me KMD-në, si dhe nëpërmjet parashtrimeve me shkrim, në mes të tjerash informoi se: *“Dënimi im është marrë nga Komiteti Ekzekutiv i FSHV-së me Vendimin nr. 5, datë 25.10.2019, ndërkohë që ka disa argumente dhe fakte se ky vendim është marrë shumë më përpara datës 25.10.2019, ndërkohë që ka dyshime të arsyeshme se zbardhja (shkrimi) i këtij akti të jetë bërë shumë më vonë datës 25.10.2019. Më poshtë po rendis disa fakte që provojnë pretendimet e mia.*

Sezoni sportiv i FSHV-së fillon si rregull në mesin e muajit shtator dhe paraprihet nga një mbledhje me arbitrat. Në mbledhjen e radhës në shtator 2019, unë nuk jam njoftuar për të marrë pjesë, por kam marrë dijeni nga kolegët e tjerë për datën, orën dhe vendin e mbledhjes. Duke qenë përpara kësaj shtate të paprecedent kam kërkuar sqarime se përse nuk jam njoftuar si gjithë arbitrat e tjerë? Përgjigja nga Presidenti i FSHV-së, ishte se jam dënuar nga Komiteti Ekzekutiv për prishje të imazhit të FSHV-së. Nga mesi i muajit shtator 2019 deri me datë 25.10.2019 (data e vendosur në vendimin e dënimit tim) janë 5-6 javë me aktivitete të FSHV-së (kupa dhe kampionati kombëtar) dhe se përgjatë gjithë këtij segmenti kohor nuk jam aktivizuar në asnjë ndeshje nga Komisioni Tekniko-Arbitral, i cili është përgjegjës për caktimin dhe emërimin e arbitrave në ndeshjet zyrtare të FSHV-së. Pra edhe pse në mungesë të marrjes së një vendimi zyrtar të dënimit përkundrejt personit tim, Komisioni Tekniko-Arbitral, organ i FSHV-së, ka vepruar sikur ky vendim të ketë ekzistuar. Në fakt del qartë se ky komision ka zbatuar udhëzimet me gojë të Presidentit të FSHV-së dhe jo vendimin zyrtar, të zbardhur në Vendimin nr. 5 të datës 25.10.2019. Me datë 24.10.2019, një ditë përpara marrjes së Vendimit nr. 5, datë 25.10.2019, ekziston një korrespondencë me e-mail mes meje dhe Kryetarit të Komisionit të Arbitrave të CEV (Konfederata Europiane e Volejbollit). Me anë të këtij e-maili më njofton shprehimisht se: “...para disa ditësh kam marrë listën e arbitrave ndërkombëtarë nga FSHV dhe mungonte emri yt. Pyetjes së z. Gaspari drejtuar Komisionit Tekniko-Arbitral të FSHV se përse mungonte emri im në listë, komisioni iu përgjigj se, R.O është pezulluar për një periudhë 2-vjeçare si arbitre kombëtare dhe ndërkombëtare dhe se R.O është njoftuar për këtë”. Kjo përgjigje është një tregues i qartë që dënimi ka qenë i paragjykuar dhe paracaktuar shumë më përpara se të merrej zyrtarisht me datë 25.10.2019. Vetë fakti që tërheqja e kopjes së Vendimit

nr. 5, datë 25.10.2019, është bërë vetëm me datë 10.12.2019, pra 45 ditë pas gjoja marrjes së vendimit nga ana e KE të FSHV-së, tregon që kemi të bëjmë me shkelje të rënda procedurale dhe ndoshta deri në vendosje fiktive të datës së vendimit. Ka një pretendim nga ana e FSHV-së që justifikon vendimin për dënimin tim me punën si trajnerë e skuadrave të moshave, sikur kjo gjë është një konflikt interesi dhe bie ndesh me kodin e etikës së FSHV-së. Lidhur me çështjen se unë stërvit një ekip moshash në KS Tirana, dëshiroj të sqaroj se jam diplomuar në Akademinë e Sporteve në profilin e volejbollit, ndaj është profesioni im kryesor që përveç se mësuese e edukimit fizik të stërvit dhe drejtoj ekipe volejboli, në përputhje me kualifikimin tim, njohuritë dhe përvojat e fituara. Në asnjë rast puna ime si trajnerë e ekipeve të moshave nuk ka rënë ndesh as me rregulloren e FSHV-së dhe as me ndonjë rregullore ndërkombëtare. Asnjëherë nuk kam arbitruar ndeshje volejboli në kategorinë ku kanë marrë pjesë skuadrat e trajnuara prej meje, as të kem drejtuar ndeshje të skuadrave rivale me skuadrën që unë stërvit dhe drejtoj”.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 1 sipërcituar dhe nenin 3/1, parashikojnë se: “*Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi*”.

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të pa drejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: “*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre*”.

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i ndryshuar, në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: “*Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacionin në përmbushjen e detyrave të tij*”.

A. Lidhur me pretendimin e ankueses për diskriminim për Vendimin nr. 5, datë 25.10.2019 të Komitetit Ekzekutiv të FSHV-së.

Nga shqyrtimi i ankesës dhe bazuar në nenin 33/4, germa “dh” të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: dh) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijani për sjelljen diskriminuese”, Komisioneri vlerëson se ky pretendim i parashtruar në ankesë, nuk duhet të pranohet pasi është paraqitur përtej afateve ligjore të parashikuara nga germa “dh”, e pikës 4, të dispozitës ligjore të sipërcituar, bazuar në arsyetimin vijues:

Nga dokumentet e administruara, rezulton se akti diskriminues i pretenduar nga ankuesja, ka dalë në datë 25.10.2019. Subjekti ankues ka marrë dijani zyrtarisht për Vendimin nr. 5, datë 25.10.2019, në datë 10.12.2019 kur ka firmosur se ka marrë në dorëzim kopje të vendimit të sipërcituar.

Ankuesja ka paraqitur ankesën pranë Komisionerit, në datën 07.12.2022, pra në tejkalim të afatit 2 vjeçar të parashikuar në nenin 33/4, germa “dh”, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Lidhur me sa sipërcituar, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk përmbushet kriteri ligjor për pranimin e pretendimit për procedurën e marrjes së Vendimit nr. 5, datë 25.10.2019, për pezullimin e ankueses nga gjykimi i të gjitha ndeshjeve kombëtare dhe ndërkombëtare dhe dënimin me gjobë, por do ndjekë procedurat ligjore lidhur me pretendimin për mos heqjen e vendimit të pezullimit, pas përfundimit të afatit 2 vjeçar, në datë 25.10.2021.

B. Lidhur me trajtimin e padrejtë dhe të pafavorshëm të ankueses, pas përfundimit të afatit 2 vjeçar të pezullimit, në datë 25.10.2021.

Referuar dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit, rezulton se:

Komiteti Ekzekutiv i Federatës Shqiptare të Volejbollit me Vendimin nr. 5, datë 25.10.2019 “Për pezullimin e R.O nga gjykimi i të gjitha ndeshjeve kombëtare dhe ndërkombëtare”, ka vendosur:

1. Pezullimin për një periudhë 2 vjeçare të R.O nga gjykimi i të gjitha ndeshjeve kombëtare dhe ndërkombëtare;
2. Ulje me 1 (një) kategori në gjykim të R.O;
3. Gjobë financiare në vlerën 50.000 (pesëdhjetëmijë) lekë;
4. Ngarkohet Sekretariati i FSHV për njoftimin e R.O për t’u paraqitur pranë FSHV-së për tërheqjen e vendimit;
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Referuar dokumentacionit të shqyrtuar, rezulton se ankuesja ka tërhequr zyrtarisht vendimin e pezullimit të saj, në datë 10.12.2019, në orën 08.55.

Ankuesja pretendon se pavarësisht, se afati i pezullimit ka përfunduar që në datë 25.10.2021, Federata Shqiptare e Volejbollit, për shkak të gjinisë, nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për ta aktivizuar si arbitre në ndeshjet kombëtare apo ndërkombëtare.

Federata Shqiptare e Volejbollit me shkresën nr. 197, datë 22.12.2022 ka parashtruar se, megjithëse afati i pezullimit ka përfunduar në datën 24.10.2021, nga ana e ankueses nuk është depozituar asnjë kërkesë me shkrim në FSHV për të vazhduar veprimtarinë si gjyqtare/arbitre, si dhe ende nuk është paguar gjoba në shumën 50.000 lekë.

Komisioneri vlerëson se, marrëdhëniet ndërmjet Federatës Shqiptare të Vojejbollit dhe ankueses, i nënshtrohen përcaktimeve të akteve ligjore dhe nënligjore që normojnë marrëdhënien mes palëve. Në këtë kontekst, lidhur me veprimet e palëve, Komisioneri vlerëson si më poshtë:

Në nenin 23, pika 2 dhe 3 të ligjit 79/2017 “Për Sportin”, të ndryshuar, përcaktohet se: “ 2. *Organet e gjykimit disiplinor të federatave shqyrtojnë dhe vendosin masa ndëshkuese ndaj pjesëmarrësve në veprimtaritë, garat sportive, që kryejnë shkelje disiplinore ose teknike, në kundërshtim me rregulloren e veprimtarisë dhe/ose me rregulloren e disiplinës së federatave përkatëse.* 3. *Vendimet e organeve të gjykimit disiplinor të federatave mund të ankimohen në Këshillin e Arbitrazhit Sportiv brenda pesëmbëdhjetë ditëve kalendarike nga shpallja e tyre*”.

Në nenin 24 të ligjit 79/2017 “Për Sportin”, të ndryshuar, përcaktohet se: “2. *Këshilli i Arbitrazhit Sportiv është organi kolegjal, i cili vendos për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve për çështje të lidhura me sportin.* 4. *Çdo organizatë sportive dhe çdo sportist apo trajner me titull individual ka të drejtën e ankimit për vendimet e organeve drejtuese dhe mosmarrëveshjeve përpara Këshillit të Arbitrazhit Sportiv*”.

Në nenin 3, pika c) të Rregullores së Këshillit të Arbitrazhit Sportiv³, parashikohet se: “KAS është kompetent për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve sipas kategorive të parashikuara më poshtë: c) *Mosmarrëveshjet disiplinore duke përfshirë çështjet e mëposhtme: - Shkeljet disiplinore të kryera përgjatë veprimtarive sportive të përcaktuara në rregulloret, kodet e disiplinës, ose akte të tjera të brendshme të organizatave sportive, duke përfshirë: aktet e dhunës në terrenet sportive, fyerjen përkundrejt stafit teknik, stafit ndihmës dhe arbitrave në lojë, thirrjet fyese dhe me karakter poshtërues drejtuar organizatave sportive, sportistëve, stafit teknik dhe stafit ndihmës*”.

Veprimtaria zyrtare e FSHV-së rregullohet nëpërmjet Rregullores së Brendshme të FSHV-së, të miratuar nga Komiteti Ekzekutiv i FSHV-së në datë 26.09.2018.

Kështu në nenin 3.2 të rregullores së FSHV-së përcaktohet se: “Në aktivitetet kombëtare dhe ndërkombëtare (zyrtare ose miqësore) aktivizohen zyrtarë, trajnerë, sportistë e gjyqtarë me qëndrim të mirë moral dhe të padënuar nga Komisioni i Disiplinës apo ndonjë organ tjetër i FSHV-së.....”.

Në nenin 7 të Rregullores së mësipërme përcaktohet se: “7. *Në të gjitha rastet e shkeljes së rregullores së brendshme dhe rregullores teknike të lojës, Komisioni i Disiplinës dhe Komiteti Ekzekutiv kanë të drejtë të japin dënime të ndryshme për skuadra dhe individë pjesëmarrës në veprimtaritë zyrtare*”, ndërsa në pikën 7.9.8.5 përcaktohet se: “Asnjë subjekt i dënuar nuk mund

³ Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar në datë 28.05.2022.

të marrë pjesë në aktivitetet zyrtare kombëtare, derisa të shlyejë dënimin e marrë nga organet respektive të FSHV-së”.

Në nenin 9.2.1 të rregullores përcaktohet se: *“Pranimi për të qenë gjyqtar volejbolli bëhet mbi bazën e dëshirës dhe kërkesës me shkrim të çdo individit, drejtuar Komisionit Tekniko-Arbitral. Komisioni bazuar në kriteret e kësaj rregulloreje mund ta refuzojë ose ta pranojë kërkesën e kandidatit/es”,* ndërsa në nenin 14.6 parashikohet se: *“Të gjitha mosmarrëveshjet ndërmjet Klubeve, Shoqatave dhe individëve ndërmjet tyre dhe me FSHV, do të zgjidhen në Komisionin e Arbitrazhit Sportiv (KAS) pranë KOKSH”.*

Referuar deklaramit⁴ të bërë nga ankuesja gjatë seancës dëgjimore, rezulton se ajo nuk ka bërë asnjë veprim për të kundërshtuar Vendimin nr. 5, datë 25.10.2019 të Komitetit Ekzekutiv të FSHV-së, në KAS, nuk ka paguar gjobën, si dhe nuk ka bërë kërkesë pranë FSHV-së, për të vazhduar veprimtarinë si gjyqtare/arbitre.

Referuar legjislacionit të sipërcituar, Komisioneri vlerëson se ankuesja duke mos qenë dakord me vendimin e FSHV-së, duhet ti ishte drejtuar KAS-it për të kundërshtuar vendimin e Komitetit Ekzekutiv të FSHV-së. Duke qenë se ankuesja nuk e ka kundërshtuar vendimin në KAS, duhej që në përfundim të afatit të pezullimit të paguate gjobën dhe të bënte kërkesë për tu rikthyer si gjyqtare/arbitre, pasi referuar vendimit, ankesja është dënuar dhe me ulje të 1 (një) kategorie në gjykim.

Për sa më lart, Komisioneri në referim të pikës 7.9.8.5 të rregullores së FSHV-së, vlerëson se ankuesja nuk mund të riaktivizohet automatikisht si gjyqtare, menjëherë pas përfundimit të afatit të pezullimit, pasi në vendim ankuesja është dënuar me pezullim për 2 vjet, me ulje në kategori dhe me gjobë dhe për zbatimin e plotë të këtij vendimi duhet që të paguhet gjoba dhe të bëhet kërkesë në FSHV, për tu riaktivizuar sipas kategorisë së rishikuar.

Në këto kushte provohet se ankuesja nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë e të pafavorshme, dhe se nga ana e FSHV nuk është bërë shkelje e procedurës ligjore që duhet ndjekur për rikthimin e ankueses si gjyqtare/arbitre.

Diskriminimi përkufizohet në nenin 3, pika 1 të Ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”,* të ndryshuar, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si nga ligjet në fuqi”.*

⁴ Referuar deklaramit gjatë seancës dëgjimore të datës 19.01.2023, min 29.00 e në vijim: *“Pas këtij vendimi nuk kam bërë asnjë veprim, nuk kam kundërshtuar vendimin në KAS.... Nuk i jam drejtuar FSHV-së për kthim, pasi nuk e shoh të arsyeshme dhe nuk mund të paguaj gjobën”.*

Komisioneri, vlerëson se për sa më sipër, nuk konstatohet se ka shkelje të nenit 7/1⁵, të Ligjit 10221/2020 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, nga ana e Federatës Shqiptare të Volejbollit, lidhur me riaktivizimin e subjektit ankues si gjyqtare/arbitre në përfundim të afatit të pezullimit.

Në përfundim, Komisioneri vlerëson se ankuesja nuk është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues nga ana e Federatës Shqiptare të Volejbollit.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenet 1, 3/1, neni 7/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të R.O, nga ana e Federatës Shqiptare të Volejbollit, për shkak të gjinisë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

⁵ Neni 7 i LMD-së, të ndryshuar, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.